

Faza e parë  
Debate publike për procesin e hartimit të Kushtetutës së Kosovës

Vendi: Mitrovicë, (4 shkurt, 2008) / Kuvendi Komunal

Panelistët: Hajredin Kuçi, Kadri Kryeziu, Mahir Jagcilar

Fjala e panelistëve: (përmbledhje e shkurtë e diskutimit)

**Hajredin Kuçi**

Kemi filluar një debat për Kushtetutën e re të Kosovës dhe ky debat dallon prej debateve të tjera. Kësaj radhe debatit për Kushtetutën nuk ka nevojë t'i frikësohet asnjë qytetar i Kosovës. Mbi të gjitha, kjo Kushtetutë tenton që të planifikojë të ardhmen e Kosovës dhe të qytetarëve të saj. Kemi menduar që debatin ta bëjmë në dy faza: faza e parë është kjo që ka filluar më 28 janar dhe do të përfundojë më 8 shkurt, ku qytetarët do të njoftohen për proceset e hartimit të Kushtetutës. Në fazën e dytë, që do të fillojë pas 8 shkurtit, do të flasim për përmbajtjen e Kushtetutës së Kosovës. E dimë se ka pasur shumë kërkesa për Draftin Kushtetues, dhe unë konsideroj se është mirë fillimisht të na thuan se çka duhet të shkruajmë, që pastaj ne t'jua ofrojmë të shkruar. Në komisionin kushtetues kemi pasur parasysh që të përfshijmë edhe njerëz të cilët kanë një të kaluar të tyre politike e edhe profesionale. Komisioni Kushtetues ka 21 anëtarë, kurse në kuadër të tij bëjnë pjesë ekspertë të njohur të Kosovës, por edhe njerëz me ndikim nga të gjitha forcat politike vendore duke përfshirë edhe ato të komunitetit serb i cili nuk ka marrë pjesë drejtpërdrejtë. Ai ka qenë i informuar me procesin kushtetues. Ne kemi bashkëpunuar me shumë ekspertë vendorë dhe besoj se ekspertët më eminentë vendorë janë përfshirë në procesin e hartimit të draft-kushtetutës, por njëkohësisht edhe me ekspertë ndërkombëtarë.

Në komisionin kushtetues nuk është vërejtur asnjë dallim nga pikëpamja politike, por është vërejtur një homogjenitet i plotë, edhe pse kemi qenë heterogjenë për nga e kaluara jonë politike, kemi funksionuar si një trup i vetëm, dhe kemi arritur tri konsensus: konsensusin në rrafshin politik, konsensus në rrafshin nacional, (ajo çka është hartuar me pëlqimin e plotë të gjithë anëtarëve vendorë dhe atyre ndërkombëtarë); dhe konsensusi i tretë ka qenë me komunitetin jo shumicë. Me kushtetutën e re të Kosovës, Kosova do të përfaqësohet sipas vullnetit të qytetarëve të saj. Ne Kosovën e kemi definuar si shtet sovran, të pavarur dhe demokratik. Cili është qëllimi i këtij debati? Qëllimi është që t'ju bindim juve që kemi punuar në përputhje me vullnetin tuaj dhe që pastaj pronësinë për Kushtetutën ta merrni ju. Kushtetuta nuk i takon asnjë institucioni, asnjë Komisioni Kushtetues, asnjë anëtar i komisionit, por i takon qytetarëve të Kosovës.

**Kadri Kryeziu:**

Me fillimin e hartimit të draftit kushtetues janë marrë parasysh tri çështje themelore: vullneti i popullit që është çështje themelore e të gjitha kushtetutave të bëra deri më tani, pastaj kemi konsideruar dhe kemi qenë të obliguar të fusim dhe elementin e jashtëm që është Pakoja e Ahtisarit, të drejtat dhe liritë e njeriut, dhe një element të veçantë të drejtat dhe liritë e minoriteteve.

Pushteti shtetëror është ndarë në Legjislativ, Ekzekutiv dhe Gjyqësor, ku secili do të bëjë punë të veçantë por ka kontroll mes veti. Pushteti Legjislativ është Parlamenti i Kosovës i cili është organi

vendimmarrës, organ në të cilin zgjidhet presidenti, kryeministri dhe Qeveria. Kosova do të ketë një sistem të qeverisjes Republikë Parlamentare me elemente të sforcuara gjysmë-presidenciale. Për herë të parë në historinë e re të Kosovës, Kosova do ta kenë edhe Gjykatën Kushtetuese të cilat do të emërohen nga presidenti i Kosovës në bashkëpunim me kryeministrin.

### **Mahir Jagcilar**

Unë përfaqësoj komunitetin turk në këtë komision, kurse në komision ka përfaqësues edhe nga komuniteti egjiptian dhe turk. Komiteti serb fatkeqësisht deri më tani nuk ka marrë pjesë, por ata janë informuar rreth zhvillimeve. Unë do të flas rreth të drejtave të njeriut dhe komuniteteve, sepse do të ketë dy kapituj të veçantë për të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre.

Kur thuhet komunitete, mendohet vetëm për komunitetin apo pakicat të cilat janë numerikisht më të vogla të cilët kanë veçoritë e tyre. Me Kushtetutë do të jenë disa nene të cilat i rregullojnë të drejtat e komuniteteve nga aspekti i përfaqësimit në institucione, përdorimi i gjuhës, përdorimi i flamurit në pajtim me ligj, etj.. Gjithashtu ekzistojnë nene në të cilat thuhet se arsimimi është i garantuar në nivel fillor dhe të mesëm, por në nivelin universitar ende ka bisedime, por besoj se do të rregullohet në gjuhën amtare edhe në Universitet.

Me Kushtetutë njihen edhe standardet ndërkombëtare, sidomos Korniza nga Këshilli i Evropës për mbrojtjen e pakicave kombëtare, pastaj Korniza nga Këshilli i Evropës për gjuhën regjionale apo të pakicave. Ne jemi të përfaqësuar edhe në institucionet shtetërore dhe ato publike, do të jenë vendet e garantuara. Për dy mandatet e para do të jenë vendet e rezervuara, 10 vende për komunitetin serb dhe 10 vende për pakica jo - serbe. Do të kemi vend në Qeverinë e Kosovës si dhe në komuna ku jetojnë mbi 10%, ku Zv/ Kryetari do të jetë prej komunitetit pakicë. Nënkryetari do të ketë kompetenca më shumë, do të ketë të drejtën të paraqesë edhe në gjykatën supreme. Ne si komunitet kemi marrë pjesë dhe do të jemi pjesë aktive, sepse Kushtetuta është akti më i lartë juridik për një shtet i cili rregullon të ardhmen dhe një jetë më të mirë për të gjithë qytetarët.

### **Pyetjet / komentet e qytetarëve**

**Qytetar:** Si ka mundësi të ndërrohet Kushtetuta kur për të nuk bëhet referendum?

**Hajredin Kuçi:** Shumë të drejtë kanë qytetarët të dalin në referendum. Kush është ai që nuk e do referendumin? Por kjo kushtetutë është paraparë që të miratohet në Kuvendin e Kosovës me 2/3 e votave. Kjo është forma më legale, më legjitime e mundshme. Referendumi është i paraparë edhe me Pakon e Ahtisarit të cilën e ka miratuar Kuvendi i Kosovës. Në dokumentin e Ahtisarit thuhet se Kosova do të jetë shtet sovran dhe i pavarur, por jo me të drejtë bashkimi me ndonjë shtet tjetër. Shteti në shekullin XXI nuk bëhet vet. Kosova duhet të bashkëpunojë me të tjerët. Decentralizimin duhet ta dallojmë prej të drejtave shtesë që janë dhënë për komunitete. Decentralizimi ndodh edhe në vende të tjera të botës, nuk është proces që fillon dhe mbaron me Kosovën. Mendoj se të drejtat që u janë dhënë komuniteteve janë kundërvlerë e asaj që kemi pretenduar ta fitojmë shtetin.

**Qytetar:** Si do të zgjedhen Gjykata Supreme dhe Gjykatësit? Pse nuk parashihet që presidenti të zgjidhet nga populli? A do të shkojë mënyra e zgjedhjes së Drejtorit të Shërbimit të Inteligjencës përmes Kuvendit dhe a do të ketë Kosova edhe Këshillin e Sigurimit Kombëtar?

**Hajredin Kuçi:** Ne kemi paraparë që gjyqësorin ta ndajmë nga sistemet tjera. Kompetencën kryesore do ta ketë Këshilli Gjyqësor i Kosovës në të cilin shumica janë gjyqtarë. Presidenti i Kosovës do të bëjë emërimin në bazë të propozimeve të Këshillit, sepse nuk do të ketë mundësi presidenti të zgjedh dikë gjyqtar ose të emërojë nëse nuk e ka marrë propozimin paraprak. Edhe shkarkimi i gjyqtarëve do të bëhet në të njëjtën mënyrë. Është një institucion i pavarur i cili largohet prej Kuvendit, prej presidentit

dhe prej Qeverisë. Kjo është përvojë e shteteve demokratike, është përvojë e re për Kosovën dhe i garanton gjyqësorit pavarësi të plotë.

Gjithashtu Kosova do të ketë sistemin parlamentar, sepse kemi menduar se për momentin duhet ta forcojmë shtetin, institucionin e presidentit si simbol i unitetit të vendit. Kemi pasur parasysh se po ndërtojmë një kushtetutë për shumë gjenerata. Në një të ardhme të afërme, kurdo që mendojnë qytetarët, ne do ta mbështesim mundësinë e referendumit. Është paraparë që Kosova të ketë Këshillin Nacional, që në kohën e gjendjes normale e udhëheq kryeministri i vendit, kurse në gjendje të jashtëzakonshme apo të luftës, Presidenti i vendit. Kjo është një zgjidhje optimale. Kosova do të ketë edhe Shërbimin e Inteligjencës që i përgjigjet pushtetit civil dhe që e kontrollon pushtetin civil. Emërimi bëhet në konsultim me kryeministrin.

**Kadri Kryeziu:** Kushtetuta e Kosovës i ka të gjitha atributet e një Kushtetute të një vendi dhe shteti. Sa i përket Shërbimit të Inteligjencës për këtë kemi luftuar dhe për këtë na kanë ndihmuar edhe ndërkombëtarët që për herë të parë në Kushtetutën e re të Kosovës si shtet ta fusim si kategori kushtetuese këtë shërbim si dhe policinë e Kosovës. Është futur edhe gjendja e jashtëzakonshme, forca e sigurisë dhe forcat e armatosura. Propozimi do të bëhet nga kryeministri së bashku me presidentin dhe në konsultim me Qeverinë e Kosovës. Shërbimi Inteligjent do të mbikëqyret nga një komision i veçantë për siguri nga Parlamenti i Kosovës. Forcat e sigurisë së Kosovës parashihen edhe me Pakon e Ahtisarit, do të mbikëqyren nga Ministria e Mbrojtjes kurse policinë Ministria e Punëve të Brendshme. Kushtetuta quhet edhe ligj, në disa kushtetuta të botës quhet kështu.

**Qytetar:** A të drejtë kryetari i Kosovës të jetë anëtarë i ndonjë partie? A parashihet t'i lihet mundësi kapitalit të huaj në Kosovë?

**Hajredin Kuçi:** Me tërë mundin tonë do të mundohemi të ruajmë unitetin e Kushtetutës. Kushtetuta nuk i takon një partie, as në kuptimin pozitiv dhe as në kuptimin negativ. Kemi menduar që kryetari i vendit të jetë simbol i unitetit. Është e pranueshme për të gjithë qytetarët që presidenti t'i takojë gjithë qytetarëve të Kosovës. Në aspektin ekonomik kemi menduar se kemi bërë një zgjedhje të drejtë, por mos harroni se Kosova ka pretendime të anëtarësohet në Unionin Evropian. Është paraparë Banka Qendrore e Kosovës, Autoriteti Qendror Bankar edhe në kuptimin e investimeve të huaja. Ne duhet të jemi të kujdesshëm të forcojmë kapitalin tonë, por nuk mundemi me ligj t'i pengojmë të tjerët të cilët ofrojnë kushte më të mira.

**Qytetar:** Si është paraparë çështja e pronës si çështje shumë e ndjeshme që nga e kaluara e deri më sot, dhe çështjet e ndara të pushteteve, si do të funksionojnë ato?

**Hajredin Kuçi:** Ne e kemi bërë kategori kushtetuese mbrojtjen e pronës, dhe prona private është e mbrojtur me kushtetutë.

**Ramadan Kelmendi:** Është me rëndësi se çfarë ka përcaktuar preambula. Kërkoj që preambula të përmbajë vullnetin e popullit shqiptar dhe atë historik në mënyrë kronologjike. Sa kam informacione në këtë projekt, është larguar elementi historik, i luftës dhe elementi i bazueshmërisë juridike i akteve burimore kushtetuese. Kjo nuk është mirë, sepse çdo popull përcakton edhe të kaluarën e tyre historike. Mendoj se Kosova duhet të jetë shtet demokratik i kombit shqiptar dhe i gjithë pakicave që jetojnë në të. Territori i Kosovës duhet të përcaktohet unik dhe sot nuk e kemi unik. Duhet të caktohet me kushtetutë që kufijtë e Kosovës, por edhe kufijtë komunalë, duhet të caktohen me referendum,

**Qytetar:** Dihet se Kushtetuta ka pjesë të Pakos së Ahtisarit. A do të jetë e vështirë të ndryshohet?

**Hajredin Kuçi:** Miratimi i Kushtetutës do të jetë edhe më i lehtë se ndryshimi i saj. Si komision kushtetues kemi qenë shumë të kujdesshëm në procesin e hartimit të këtij drafti kushtetues. Arsyeja është se ndryshimi i saj duhet të kërkohet me 2/3, e edhe të komuniteteve jo shumicë. Jemi të vetëdijshëm për punën që po e bëjmë, dhe e dimë se këto ndryshime nuk mund t'i bëjë veç një komision kushtetues, por edhe rrethana të tjera jashtë këtij komisioni. Ne do të mundohemi të bëjmë një kushtetutë të përhershme. Nëse ligji nuk i bie taman një populli, duhet të ndryshohet ligji e jo populli.

**Qytetar:** U tha se Kosova do të jetë shtet laik. A do të ketë vend në kushtetutën e Kosovës edhe për mësimin fetar? Kushtetuta e Kosovës a do të jetë e barabartë në ruajtjen e trashëgimisë kulturore për të gjitha bashkësitë fetare, apo vetëm për një komunitet?

**Hajredin Kuçi:** Mendoj se definimi i Kosovës si shtet laik është një definim i çdo shteti modern dhe demokratik. Kjo nuk nënkupton që t'i humbet e drejta dikujt të ushtrisë besimin fetar. Çdo qytetar do ta ketë të drejtën për besim fetar, pa ndikim dhe përzierje me shtetin.

Çështja e mësimin fetar nuk është çështje që rregullohet me kushtetutë, kushtetuta rregullon çështjet parimore. Çështja e trashëgimisë kulturore në kushtetutë garantohej, edhe ruajtja e identitetit kulturor, identitetit fetar e gjuhësor. Trashëgimia ka qenë pjesë e negociatave, dhe si pjesë të saj duhet ta respektojmë.

**Kadri Kryeziu:** Për shkak të sensibilitetit të kësaj çështje dhe ndjeshmërisë së madhe, në takimet të cilat i kemi pasur me qytetarët, kanë ngritur problemin e fesë. Ne kemi vendosur që Kosova të jetë qytet laik, sepse është në relacion me shumë kushtetuta botërore të cilat kanë të përcaktuar fenë. Ne nuk kemi vendosur se çfarë feje do të jetë në Kosovë përmes kushtetutës. Të gjithë qytetarët sipas kushtetutës kanë të drejtë që të organizohen në besimin e tyre fetar.

**Qytetar:** Kemi shqetësime në shumë pika.

**Hajredin Kuçi:** Me botimin e draftit do të zvogëlohen ato dilema. Unë jam i bindur se edhe me sugjerimet tuaja, ditën e miratimit të kushtetutës secili qytetar i Kosovës ta ndiejë vetën mirë, dhe duhet t'i gëzohen asaj.

**Qytetar:** Vij nga pjesa veriore e Mitrovicës ku pjesa e pushtetit nuk ka qasje në popullatën shqiptare. Ju njoftoj juve si komision që unë nuk mund ta vizitoj shtëpinë time në atë pjesë, që të gjithë qytetarët të jetë të barabartë.

**Hajredin Kuçi:** Komisioni Kushtetues ka pasur dhe ka për obligim ta garantojë tërësinë territoriale të Kosovës, pacenueshmërinë e territorit të saj përfshirë edhe Veriun e Mitrovicës dhe garantimin e të drejtave të të gjithë qytetarëve në çdo pjesë të Kosovës. Çështja e integritetit që po e quajmë Veriu i Mitrovicës është çështje edhe e mekanizmave të tjerë dhe jo vetëm e komisionit kushtetues.

**Qytetar:** Sa do të ketë ndikim Pakoja e Ahtisarit në këtë kushtetutë sepse kemi përvoja të hidhura?

**Hajredin Kuçi:** Është e vërtetë se Pakoja e Ahtisarit është respektuar në draftet kushtetuese, por po e përsëris, është respektuar, por nuk e cenon pavarësinë e Kosovës, nuk e cenon tërësinë territoriale dhe funksionalitetin e institucioneve të Kosovës në tërë territorin.

**Qytetar:** A do të bëhet bashkimi i Mitrovicës gjatë mandatit tuaj?

**Hajredin Kuçi:** Unë nuk i them se kjo do të ndodhë për një javë, por ka filluar të integrohet. Ne kemi garanci se tërësia territoriale e kufirit do të ruhet, që Misioni i Unionit Evropian do të jetë në çdo pjesë të Kosovës.

**Qytetar:** Siç shihet serbëve iu janë shumë më shumë të drejta në krahasim me pakicat tjera, a e shihni ju këtë si diskriminim?

**Hajredin Kuçi:** Rasti i diskriminimit që në fjalorin tonë ka hyrë si diskriminim pozitiv duhet ta pranojmë se në Kosovë pakicat kanë më shumë të drejta se që kanë në vende të tjera, por në kuptimin politik këtë e kemi bërë për hir të shumicës.